



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**VENDIM**  
**Nr. 160, datë 28.04.2022**

**PËR**  
**NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.158, DATË 21.04.2022 TË**  
**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në shkresën nr.939/1 prot., datë 27.04.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

- I. Ndryshimin e pikës I, nënndarja “Gjykata Apelit Shkodër”, faqe 2, të Vendimit Nr.158, datë 21.04.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë:

*“1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: Armend Pervezi; Akuza: “Për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.*

- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**